



AKTUALE



MBYLLET QEVERIA AMERIKANE F. 2

SI NDIKON ZBATIMI I RREPTE I LIGJIT PËR TË HUAJT TE SERBËT NË KOSOVË? F. 7

RAPORTI I IKD-së: TETË KANDIDATË PËR KRYETARË KOMUNASH KANË PROBLEME ME LIGJIN F. 6

EKONOMI



NGA BUKA DERI TE PERIMET, QYTETARËT PO PËRBALLEN ME NGRITJE TË ÇMIMEVE F. 8

SHAHINI: KOSOVA KRYESON NË BOTË ME TKURRJEN E POPULLSISË, EKONOMIA NË ALARM F. 8

SPORT



TETORI KUQEZI, NJË MUAJ PLOT NDESHJE DHE EMOCIONE PËR KOMBËTAREN SHQIPTARE F. 11

28 VJET NGA PROTESTA STUDENTORE E 1 TETORIT 1997 QË ZGJOI SHPIRTIN E LIRISË



Liderët e Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, kanë kujtuar të mërkurën 28-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit 1997. Ata thanë se Lëvizja Studentore (1997-1999) nisi me kërkesën për lirim të objekteve universitare dhe u shndërrua në një lëvizje të fuqishme popullore kundër okupimit serb, duke sensibilizuar opinionin ndërkombëtar, mbështetur UÇK-në dhe ndikuar në procesin e statusit politik të Kosovës. Për përvjetorin e kësaj proteste që ndryshoi historinë e popullit të Kosovës, kanë shkruar edhe presidentja Vjosa Osmani dhe liderët e partive politike

BE-ja BËN THIRRJE PËR FORMIMIN E SHPEJTË TË INSTITUCIONEVE TË REJA TË KOSOVËS F. 5



QELAJ: KA TENDENCË TË VAZHDUESHME PËR T'I GODITUR INSTITUCIONET E PAVARURA F. 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

MBYLLJET QEVERIA AMERIKANE

UASHINGTON, 1 TETOR - Qeveria amerikane nisi mbylljen në mesnatë, pasi ligjvënësit dhe presidenti amerikan, Donald Trump, dështuan të arrinin një marrëveshje për shpenzimet gjatë bisedimeve të tensionuara që u kushtëzuan nga kërkesat e demokratëve që të financohet kujdesi shëndetësor. Kjo është hera e parë që qeveria amerikane mbyllet pas mbylljes më të gjatë në histori - që zgjati 35 ditë - para pothuajse shtatë vjetësh, dhe do ta ndalojë punën në disa departamente dhe agjenci federale duke prekur qindra mijëra punonjës qeveritarë. Trumpi fajësoi demokratët për bisedimet që ngecën dhe kërcënoi se do ta ndëshkonte partinë dhe votuesit e saj gjatë mbylljes, duke paralajmëruar se do të shënjestrojë disa prioritetet progresive, duke detyruar shkurtime masive në vendet e punës në sektorin publik. “Do të largojmë nga puna shumë njerëz që do të preken shumë dhe ata do të jenë demokratë”, tha Trumpi për gazetarët në Zyrën Ovale. Ai shtoi se “shumë gjëra të mira do të vijnë nga mbyllja”, duke sugjeruar se do ta përdorë këtë ndërprerje për “të hequr qafe shumë gjëra që nuk i donim, dhe

ato gjëra do të jenë të demokratëve”. Operacionet qeveritare nisën të paralizoheshin pas mesnatës, pas një përpjekjeje të dështuar në Senat për miratimin e një rezolute afatshkurtër të financimit, që veçse është miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve. Shpresat për një kompromis u zbehën prej të hënës, kur një takim i minutës së fundit në Shtëpinë e Bardhë nuk solli asnjë përparim. Demokratët, që janë pakicë në dy dhomat e Kongresit, kanë synuar të kenë ndikim mbi qeverinë federale, tetë muaj pasi Trumpi nisi mandatin e dytë presidencial. Kërcënimi i Trumpit për shkurtime të reja të vendeve të punës i ka rritur shqetësimet në mesin e punëtorëve federalë, pas largimeve masive nga puna më herët gjatë këtij viti nga Departamenti për Efiçencë Qeveritare që u drejtua nga Elon Musk. Në Senatin prej 100 anëtarësh kërkoheshin 60 vota për ta kaluar projektligjin për shpenzime. Republikanët kishin propozuar që ta zgjasnin financimin aktual deri në fund të nëntorit, me qëllim që të zhvilloheshin negociata për një plan afatgjatë për shpenzime. Por, demokratët kërkuan që të



riktheheshin qindra miliarda dollarë në shpenzimet për kujdesin shëndetësor, veçmas për programin për sigurime shëndetësore Obamacare, për familjet me të ardhura të ulëta që, me gjasë, administrata e Trumpit do ta largojë nga financimi. Pothuajse të gjithë demokratët në Senat votuan kundër projektligjit që kishte kaluar në Dhomën e Përfaqësuesve. Mbetet e paqartë se sa do të zgjasë mbyllja.

Qeveria federale është mbyllur 21 herë që nga viti 1976, kur Kongresi miratoi procesin e ri për miratimin e buxhetit. Disa mbyllje kanë zgjatur vetëm disa orë dhe nuk kanë pasur ndikim në funksionimin e qeverisë. Mbyllja më e gjatë, ndërkaq, nisi më 22 dhjetor 2018, kur demokratët dhe Trumpi nuk arritën pajtim për 5.8 miliardë dollarët që presidenti i kërkonte për murin në kufi me Meksikën.

Atëbotë pothuajse 380 mijë punonjës federalë u dërguan në pushim administrativ, ndërkaq 420 mijë të tjerë punuan pa pagesë. Mbyllja e re nuk do t'i prejë funksionet vitale, sikurse janë shërbimet postare, ushtria, programet për mirëqenie. Por, deri në 750 mijë punonjës mund të dërgohen në shtëpi dhe nuk do të mund të paguhen derisa të përfundojë mbyllja, sipas Zyrës për Buxhet të Kongresit.

MUNDËSIA PËR JETË NË HËNAT E SATURNIT RRITET PAS ZBULIMIT TË PËRBËRËSVE ORGANIKË

BERLIN, 1 TETOR - Një oqean i fshehur nën shtresën e akullit të hënës së Saturnit, Enkeladus, përmban molekula komplekse organike, sipas një studimi të publikuar më 1 tetor, duke ofruar dëshmi të mëtejme se në këtë botë të vogël mund të ketë të gjithë përbërësit e nevojshëm për të pasur jetë jashtëtokësore. Vetëm 500 kilometra gjerësi dhe e padukshme me syrin e lirë, hëna Enkeladus është një prej qindra hënave që rrotullohen rreth planetit të gjashtë nga Dielli. Për një kohë të gjatë shkencëtarët besonin se Enkeladusi ishte shumë larg nga Dielli - dhe për pasojë shumë i ftohtë - për të qenë i banueshëm. Më pas, sonda Cassini fluturoi disa herë pranë kësaj hëne gjatë një udhëtimi për në Saturn dhe në unazat e tij në periudhën 2004-2017, duke zbuluar prova se një oqean i madh me ujë të kripur fshihet nën një shtresë akullnajore, prej disa kilometrash, të hënës. Që atëherë shkencëtarët kanë analizuar të dhëna të mbledhura nga sonda Cassini, duke zbuluar se oqeani ka shumë nga elementet që mendohet se janë të nevojshme për të mundësuar jetën, përfshirë krip, metan, dyoksid karboni dhe fosfor. Kur sonda kaloi mbi polin jugor të



hënës, zbuloi ujë që shpërthente përmes të çarave në sipërfaqe. Ky ujë nxirrte grimca të vogla akulli - më të vogla se kokrrat e rërës - në hapësirë. Ndërsa disa prej këtyre grimcave të akullit binin sërish në sipërfaqen e hënës, të tjerat grumbulloheshin rreth njërës prej shumë unazave të Saturnit. Kur Cassini fluturoi nëpër unazën më të jashtme të Saturnit, të quajtur “E”, ai “zbuloi mostra nga Enkeladusi gjatë gjithë kohës”, tha Nozair Khawaja, shkencëtar planetar në Universitetin e Lirë të Berlinit dhe autori kryesor i

studimit të ri, në një deklaratë për Agjencinë Evropiane të Hapësirës. Duke i analizuar këto mostra, shkencëtarët më herët kishin identifikuar një numër të molekulave organike - përfshirë edhe pararendës të aminoacideve, të cilat janë shtylla kryesore e jetës. Këto grimca akulli mund të kenë pësuar ndryshime pasi janë bllokuar në unazë për qindra vjet - ose janë dëmtuar nga shpërthimet e rrezatimeve kozmike. Prandaj, shkencëtarët duan të analizojnë

disa grimca të reja akulli dhe, fatmirësisht, ata veç kanë qasje në disa prej tyre. Kur Cassini fluturoi direkt në spërkatjen e ujit që dilte direkt nga sipërfaqja e hënës më 2008, grimcat e akullit e goditën analizuesin e pluhurit kozmik të sondës në rreth 18 kilometra për sekondë. Por, u deshën vite për ta përfunduar analizën e detajuar kimike të këtyre grimcave, e cila është temë e studimit të botuar në revistën Nature Astronomy. Bashkautor i studimit, Frank Postberg, tha se studimi dëshmon

se “molekulat komplekse organike që detektoi Cassini në unazën E të Saturnit nuk janë vetëm produkt i ekspozimit të gjatë në hapësirë, por janë lehtësisht të pranishme në oqeanin e Enkeladusit”. Astrokimistja franceze, Caroline Freissinet, e cila nuk është e përfshirë në studim, tha për AFP-në se “ka pak dyshim” që këto molekula ishin në oqeanin e hënës. Por, ky konfirmim ofron “një copëz tjetër në këtë mozaik”, shtoi ajo. Sipas saj, kjo dëshmon se teknologjitë e reja, sikurse inteligjenca artificiale, u mundësojnë shkencëtarëve të kryejnë analiza të reja në të dhëna të vjetra. Freissinet tha që mënyra më e mirë për të kuptuar se çfarë po ndodh në Enkeladus është që një mision të ulet pranë kësaj zone dhe të marrë mostra të akullit. Agjencia Evropiane e Hapësirës ka studiuar mundësinë e një misioni që do të bënte pikërisht këtë. Tekfundit, “Enkeladusi plotëson të gjitha kushtet për të qenë një mjedis i banueshëm që do ta mbështeste jetën”, tha agjencia përmes një deklarate. Khawaja shtoi se “edhe mosgjethja e jetës në Enkeladus do të ishte një zbulim i madh, sepse ngre pyetje serioze pse jeta nuk është e pranishme në një mjedis të tillë kur ekzistojnë kushtet e duhura”.

Kosova i njofton udhëtarët për rregullat e reja të BE-së

PRISHTINË, 1 TETOR - Bashkimi Evropian do ta nisë zbatimin e sistemit të hyrje-daljeve (EES) nga 12 tetori 2025. Ky sistem ka rëndësi për të gjithë shtetasit që nuk janë nga vendet e BE-së dhe që udhëtojnë në 24 shtetet anëtare pjesëmarrëse, përveç Qipros dhe Irlandës, si dhe në katër vende joanëtare të BE-së - Norvegji, Islandë, Zvicër dhe Lihtenshtajn. EES-i i jep fund vulosjes manuale të pasaportave dhe

synon ta zëvendësojë me një sistem teknologjik në çdo aeroport ndërkombëtar, port dhe pikë kufitare tokësore, që regjistron hyrjet, daljet, shenjat e gishtërinjve dhe imazhet e fytyrës. E për këtë ka njoftuar të hënën edhe Qendra Kombëtare e Kosovës për Menaxhim Kufitar. Nëse sistemi i hyrje-daljeve përfundon në tremujorin e parë të vitit 2026, atëherë edhe mekanizmi evropian për

autorizimin e udhëtimit (ETIAS) do të hyjë në fuqi në muajt pasues, i cili do të ndikojë te të gjithë udhëtarët nga vendet që hyjnë në BE pa viza. Rreth 1.4 miliard njerëz, përfshirë ata nga Britania e Madhe, Shtetet e Bashkuara, Ukraina, Gjeorgjia, Moldavia dhe vendet e Ballkanit Perëndimor që nuk janë anëtare të BE-së, do të jenë të detyruar ta sigurojnë këtë autorizim para hyrjes në BE.



OSBE-ja KËRKON RESPEKTIMIN E VENDIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE NË KOSOVË

PRISHTINË, 1 TETOR - Misioni i OSBE-së në Kosovë ka kërkuar që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të respektohen dhe të zbatohen plotësisht pa pasur ndikim apo ndërhyrje të panevojshme. OSBE-ja ka thënë se pavarësia e institucioneve gjyqësore është gurthemel i shoqërisë demokratike, duke shprehur shqetësimin për deklaratat kundër Gjykatës Kushtetuese. “Misioni vëren me shqetësim deklaratat e fundit publike dhe iniciativat që, direkt apo indirekt, synojnë ta sfidojnë apo diskreditojnë autoritetin e Gjykatës Kushtetuese. Përpjekjet për ta politizuar punën e Gjykatës dhe sistemin

më të gjerë gjyqësor minojnë besimin publik në institucionet e Kosovës. Gërryejnë besimin në sundimin e ligjit dhe mund të vënë në pikëpyetje zhvillimin demokratik të Kosovës. Misioni i OSBE-së nënvizon se pavarësia e gjyqësorit është domosdoshmëri demokratike”, thuhet në reagimin e OSBE-së. OSBE-ja ka thënë se përfaqësuesit politikë dhe institucionet mbajnë përgjegjësi për ta respektuar autoritetin e gjykatës, duke forcuar besimin e publikut në kornizën kushtetuese të Kosovës dhe në sistemin e drejtësisë në përgjithësi. “Misioni u bënë thirrje të gjithë



aktorëve politikë ta mbështesin konstituimin e Kuvendit në përputhje me kornizën ligjore dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë ngushtë me Kuvendin dhe deputetët e tij pasi të jetë konstituuar plotësisht”, thuhet në reagim. Gjykata Kushtetuese të martën ka vendosur se Kuvendi i Kosovës nuk është i konstituuar dhe se duhet të zgjidhet nënkryetari nga radhët e komunitetit serb. Deputetëve u është dhënë afat 12 ditë, pasi të publikohet aktgjykimi, që ta konstituojnë Kuvendin. Vendimi është marrë pas ankesës së Listës Serbe.

QELAJ: KA NJË TENDENCË TË VAZHDUESHME PËR T’I GODITUR INSTITUCIONET E PAVARURA



PRISHTINË, 1 TETOR - Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka deklaruar se ekziston një tendencë për t’i goditur institucionet e pavarura. Në 25-vjetorin e themelimit të këtij institucioni, ai para diplomatëve të huaj potencoi edhe nevojën që partneriteti me aleatët të fuqizohet dhe të vazhdojë edhe më tej në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut. “Sfidën më të madhe e kemi mungesën e vullnetit politik për konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe

formimin e qeverisë dhe institucioneve të tjera që funksionojnë pas zgjedhjeve. Këto vite, për sa vite unë jam Avokat i Popullit, kam parë një tendencë që vazhdimisht, në situata të kësaj natyre, të goditen institucionet e pavarura dhe të jenë nën kërcënim në forma të ndryshme qoftë përmes deklarimeve publike, qoftë përmes anashkalimit dhe injorimit të qëndrimeve që i kryen Avokati i Popullit”, sqaroi Qelaj.

Ai shtoi se problemi më i madh që ka Kosova aktualisht lidhet me konstituimin e Kuvendit, formimin e qeverisë dhe funksionimin e institucioneve pas zgjedhjeve. “Janë 2 300 rekomandime që u janë dhënë autoriteteve publike për avancimin e respektimit të të drejtave themelore të njeriut. Janë mbi 90 agjenci ndërkombëtare që kanë mbështetur Avokatin e Popullit. Sfidën më të madhe e kemi mungesën e vullnetit politik për

konstituimin e Kuvendit të Kosovës dhe për zgjedhjen e qeverisë dhe institucioneve të tjera”, tha ai. Gjykata Kushtetuese të martën ka vendosur se Kuvendi i Kosovës nuk është i konstituuar dhe se duhet të zgjidhet nënkryetari nga radhët e komunitetit serb. Deputetëve u është dhënë afat 12 ditë, pasi të publikohet aktgjykimi, që ta konstituojnë Kuvendin. Vendimi është marrë pas ankesës së Listës Serbe.

KQZ-ja emëron më shumë se 520 ekipe të numërimit në Qendra Komunale të Numërimit

PRISHTINË, 1 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka emëruar më shumë se 520 ekipe të numërimit në Qendrat Komunale të Numërimit me mbi 2 000 anëtarë për zgjedhjet lokale që do të mbahen më 12 tetor të këtij viti. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në zgjedhjet lokale numërimi i votave të kandidatëve për kryetarë të komunave dhe votave të subjekteve politike për kuvende komunale bëhet në vendvotime pas përfundimit të votimit të cilat evidentohen në formularë.

Ndërkaq, sipas të njëjtit ligj, votat e kandidatëve për anëtarë të kuvendeve Komunale numërohen në Qendra Komunale të Numërimit, proces i cili do të realizohet përmes ekipeve të numërimit. Përveç numërimit të votave të kandidatëve për anëtarë të kuvendeve komunale, në këto qendra, sipas aktit nënligjor të KQZ-së, Rregullore Zgjedhore nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit, do të bëhet edhe verifikimi i votave të subjekteve politike, nga formularët që janë

plotësuar në vendvotime pas numërimit të fletëvotimeve. Po ashtu, KQZ mori vendim për miratimin e procedurës së veprimit në Qendrat e Komunave të Numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025. Me anë të kësaj procedure, përcaktohet themelimi, funksionimi dhe menaxhimi i QKN-ve, duke përfshirë mbikëqyrjen, pranimin e materialeve zgjedhore, numërimin e fletëvotimeve dhe verifikimin e rezultateve nga formularët e plotësuar në vendvotime.





28 VJET MË PARË, PROTESTA STUDENTORE E 1 TETORIT 1997 ZGJOI SHPIRTIN E LIRISË

Liderët e Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, kanë kujtuar të mërkurën 28-vjetorin e protestës studentore të 1 tetorit 1997. Nga ta u tha se Lëvizja Studentore (1997-1999) nisi me kërkesën për lirim të objekteve universitare dhe u shndërrua në një lëvizje të fuqishme popullore kundër okupimit serb, duke sensibilizuar opinionin ndërkombëtar, mbështetur UÇK-në dhe ndikuar në procesin e statusit politik të Kosovës. Për përvjetorin e kësaj proteste që ndryshoi historinë e popullit të Kosovës, kanë shkruar edhe presidentja Vjosa Osmani dhe liderët e partive politike

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 TETOR - Të mërkurën janë bërë 28 vjet nga protesta e Lëvizjes Studentore e vitit 1997. Ishte Lëvizja Studentore e atëhershme që organizoi protestat të cilat u organizuan për ta kundërshtuar pushtimin e Kosovës nga Serbia dhe kthimin

e studentëve në objektet universitare, nga të cilat studentët ishin dëbuar nga regjimi i Slllobodan Millosheviqit në fillim të viteve '90. Përpos masave të dhunshëm që regjimi kishte vendosur vite më parë në universitet, dëboi studentët dhe profesorë nga universiteti dhe imponoi planprogramin serb për mësim.

Kjo protestë konsiderohet një ndër aktet më të rëndësishme të asaj kohe. Për ta shpërndarë protestën paqësore, policia serbe përdori dhunë ndaj studentëve dhe profesorëve.

Në ballë të kësaj proteste ishin liderët e Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, së bashku me rektorin e atëhershëm të Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci. Pas tyre në këtë protestë ishin edhe mijëra studentë dhe profesorë. Lëvizja Studentore e '97-s u bë simbol i rezistencës së rinisë dhe qytetarëve të Kosovës ndaj regjimit serb dhe u shndërrua në promotore të luftës për liri dhe pavarësi.

E të mërkurën, liderët e Lëvizjes Studentore të '97-s, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi dhe Albin Kurti, kanë kujtuar 28-vjetorin e kësaj ngjarje historike.

Lideri i protestave studentore të 1 tetorit 1997, Bujar Dugolli, ka

shkruar në "Facebook" se protestat studentore të 1 tetorit 1997 nisën rrugën e Kosovës drejt lirisë dhe pavarësisë. "Krenohem që isha pjesë e asaj gjenerate që ndryshoi historinë", ka shkruar Dugolli.

Muhamet Mavraj, një nga ish-drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s, kujtoi 1 tetorin e atij viti, duke përmendur studentët dhe arsimtarët dëshmorë, ndër të tjerë.

Ai shkroi në "Facebook" se "Sot është Dita e Studentëve". "Mendimet e mia dhe të rrahurat e zemrës janë me studentët e arsimtarët dëshmorë, të gjithë dëshmorët, dhe me burrat në Hagë: strategët e lirisë. Respekt për 22 mijë studentët e '97-s të cilët në shtatë qendra universitare u ngritën për t'i vënë supet atdheut drejt lirisë, hap pas hapi. I tërë kombi atë ditë ishte me studentët. Gjithkush bën sipas mendjes ose shkon sot ku i thotë zemra. Kështu po ia bëj edhe unë", ka shkruar Mavraj.

Edhe Driton Lajçi, një nga liderët e Lëvizjes Studentore, e ka kujtuar këtë përvjetor. Ai ka shkruar në "Facebook" se Lëvizja studentore (1997-1999) nisi me kërkesën për lirim të objekteve universitare dhe u shndërrua në një lëvizje të fuqishme popullore kundër okupimit serb, duke sensibilizuar opinionin ndërkombëtar, mbështetur UÇK-në dhe ndikuar në procesin e statusit politik të Kosovës. "Këshilli Organizativ i Unionit të Pavarur të Studentëve dhe Universitetit të Prishtinës udhëhoqi protestat studentore dhe gjithëpopullore në vitet 1997-1998. (1, 29, 30 tetor 1997 dhe 2, 9, 13, 18 mars & 30 prill 1998) Lëvizja studentore (1997-1999) nisi me kërkesën për lirim të objekteve universitare dhe u shndërrua në një lëvizje të fuqishme popullore kundër okupimit serb, duke sensibilizuar opinionin ndërkombëtar, mbështetur UÇK-në dhe ndikuar në procesin

BE-ja BËN THIRRJE PËR FORMIMIN E SHPEJTË TË INSTITUCIONEVE TË REJA TË KOSOVËS

PRISHTINË, 1 TETOR - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, tha se komuniteti ndërkombëtar po analizon vendimin e publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, teksa u ka bërë thirrje partive politike që sa më shpejt t'i formojnë institucionet e reja. “Jemi duke e analizuar aktualisht, por sigurisht shpresa jonë është që Kuvendi të konstituohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe shpresojmë të ketë një qeveri me mandat të plotë sa më shpejt që të jetë e mundur”, tha Orav në një prononcim për medie më 1 tetor. Të martën Gjykata Kushtetuese publikoi njoftimin për vendimin lidhur me çështjen e Kuvendit, duke deklaruar se organi ligjvënës nuk është konstituuar, ashtu siç kishte pandehur në fund të gushtit kreu i ri i Kuvendit, Dimal Basha. Kushtetuesja tha se Kuvendi nuk konsiderohet i konstituuar pa zgjedhjen e nënkryetarit nga radhët e komunitetit serb. “Ju lutem, konstituojeni Kuvendin dhe ju lutem formoni një qeveri”, bëri thirrje ambasadori i bllokut evropian në Kosovë.

Kushtetuesja tha se seanca konstituive - e nisur më 15 prill - nuk ka përfunduar dhe e njëjta duhet të përfundojë brenda 12 ditësh. Aktgjykimi i plotë i Kushtetuese ende nuk është publikuar dhe vetëm pas publikimit të tij nis rrjedhja e afatit 12-ditor. Kushtetuesja urdhëroi deputetët që “në pajtim me nenin 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 7 [Vlerat], paragrafin 4 të nenit 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve] dhe nenin 74 [Ushtrimi i Funksionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që gjatë procedurës së zgjedhjes së nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga radhët e deputetëve të komunitetit serb, ta ushtrojnë funksionin e tyre kushtetues në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit”. Gjykata më e lartë në Kosovë e mori këtë vendim pas ankesës së Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - lidhur me votimin ndaras të kandidatëve për nënkryetarë të



Kuvendit të Kosovës nga radhët e pakicave. Emilija Rexhepi është zgjedhur nënkryetare e Kuvendit nga minoriteti joserb, ndërsa asnjëri deputet serb nuk i ka siguruar votat e nevojshme për pozitën e rezervuar për këtë minoritet, pavarësisht disa raundeve të votimit. Lista Serbe beson se kryetari i Kuvendit, Dimal Basha, nuk ka vepruar në mënyrë të drejtë kur, njëanshëm, e ka shpallur Kuvendin të konstituuar pa u zgjedhur edhe nënkryetari serb.

Pas pranimit të ankesës, Gjykata Kushtetuese ka vendosur një masë të përkohshme, e cila ua ka ndaluar deputetëve të ndërmarrin veprime drejt formimit të qeverisë së re deri më 30 shtator, meqë ka pasur dyshime për ndonjë shkelje kushtetuese. Kushtetuesja tha se masa e përkohshme do të mbetet në fuqi. Lëvizja Vetëvendosje - partia fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit, ka deklaruar më herët se votimi në pako i dy nënkryetarëve të

komuniteteve joshumicë nuk kërkohet me Kushtetutë, siç ka pretenduar Lista Serbe, dhe se Rregullorja e Kuvendit nuk është mbi dokumentin më të rëndësishëm të vendit. Pavarësisht se zgjedhjet janë mbajtur në shkurt, Kosova vazhdon të mos i ketë institucionet e reja. Partitë më të mëdha shqiptare nuk kanë arritur pajtueshmëri për ta çuar procesin përpara dhe, për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese është detyruar të dalë disa herë me aktgjykime. Në zgjedhjet parlamentare, Lëvizja Vetëvendosje doli e para dhe fitoi 48 ulëse në Kuvend. Partia Demokratike e Kosovës doli e dyta me 24 ulëse, Lidhja Demokratike e Kosovës e treta me 20, pasuar nga Lista Serbe me nëntë dhe koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate, me tetë të tilla. Edhe 11 ulëse të tjera janë të pakicave. Faktori ndërkombëtar ka bërë disa herë thirrje që Kosova t'i formojë sa më shpejt institucionet e reja.

e statusit politik të Kosovës. Jam krenar që i përkas brezit që me guxim kontribuoj për liri. Urime 1 Tetori 1997 dhe nderim brezit të studentëve të lirisë. Urime dita e studentëve të Kosovës!”, ka shkruar Lajçi. Edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka kujtuar 28-vjetorin e protestave të Lëvizjes Studentore, ku edhe vetë ishte pjesëmarrës. Kurti ka shkruar në “Facebook” se mijëra njerëz nga e tërë Kosova u bënë bashkë në një nga demonstrimet më masive të vullnetit politik të shqiptarëve në historinë moderne të Kosovës. “Atë ditë, më 1 tetor 1997, pas gjashtë vitesh të kaluara pa protesta dhe demonstrata, mijëra qytetarë të Kosovës iu bashkuan protestës paqësore të thirrur nga Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës (UPSUP), kundër shtypjes, dhunës dhe segregimit të shtetit të Serbisë ndaj shqiptarëve në Kosovë”, ka shkruar Kurti. Ai ka thënë se protestat studentore të kthyera në demonstrata popullore, i paraprinë dhe iu bashkëngjiten luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që pasoi



nga fundi i vitit 1997 deri në çlirimin e Kosovës në qershor të vitit 1999. 28-vjetorin e protestave studentore e ka kujtuar edhe presidentja Vjosa Osmani. Ajo ka thënë se protestat studentore të vitit 1997 ishin lajmëtari i lirisë. Osmani ka theksuar se në vitin 1997 studentët e Kosovës u ngritën jo vetëm për të drejtat e tyre, por për dinjitetin e një populli të tërë. “Ata kishin fuqinë e zërit, guximin e zemrës dhe besimin se e ardhmja nuk mund të ndërtohej mbi frikë, padrejtësi dhe terror. Në rrugët e Prishtinës,

në auditoriumet e mbyllura, në sheshet e mbushura me thirrje e pankarta, u shkrua një kapitull i artë i rezistencës sonë. Protestat studentore të vitit 1997 ishin lajmëtari i lirisë, nga të cilat secili hap shndërrohej në akt heroizmi dhe secila thirrje për drejtësi bëhej kushttrim për liri e pavarësi. Sot, kur kujtojmë atë ditë të lavdishme, përulemi me respekt para atij brezi që guxoi ta sfidojë padrejtësinë me forcën e paqes. Studentët e '97-s na mësuhan se liria nuk dhurohet, por fitohet, dhe e ardhmja nuk pritet, por ndërtohet”, ka thënë Osmani në



deklaratën për medie. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, së bashku me kryetarin Shaqir Totaj, në mesin e studentëve të Prizrenit, kujtuan 1 Tetorin e vitit 1997, ditën kur studentët e Kosovës u përballën me tanke e polici, duke e kthyer guximin e tyre në histori lirie. Krasniqi ka thënë se studentët kanë qenë gjithmonë forca më e fuqishme e ndryshimit, në Kosovë, në Evropë dhe kudo në botë. “Sot, fatmirësisht, ata nuk përballen më me tanke, por dilemat e tyre mbeten të mëdha: të qëndrojnë apo të largohen, ta

ndjekin ëndrrën apo të pajtohen me rutinën, të jenë thjesht profesionistë apo edhe qytetarë aktivë që e ndryshojnë shoqërinë. Mesazhi im për ta ishte i shkurtër, i thjeshtë dhe i qartë: Mos u kënaqni me pak. Kërkoni më shumë. Kërkoni një Kosovë më të mirë. Sepse Kosova nuk e ka luksin të humbasë asnjë student, asnjë të ri. Sepse e ardhmja e shtetit tonë nuk shkruhet nga askush tjetër përveç jush. Ashtu si brezi i '97-s që zgjoi shpirtin e lirisë, brezi juaj ka për detyrë ta ndërtojë të ardhmen që Kosova e meriton. Ju jeni brezi që do ta shkruajë kapitullin e ri të këtij vendi. Dhe ai kapitull do ta ketë vetëm një titull: Kosova është e të rinjve të saj!”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se historia e shqiptarëve është histori përpjekjesh të pandala për liri. “Më 1 tetor 1997 rinia studentore dhe profesorët universitarë dëshmuhan vendosmërinë për t'u ngritur mbi padrejtësitë dhe për ta paralajmëruar ndryshimin e madh, luftën për liri dhe pavarësi”, ka deklaruar Haradinaj.

Universiteti European i Tiranës nderon Ali Ahmetin me titullin ‘Doctor Honoris Causa’

TIRANË, 1 TETOR - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, është nderuar të mërkurën nga Universiteti European i Tiranës me titullin “Doctor Honoris Causa”. “Sot pata nderin e

veçantë të pranoj titullin ‘Doctor Honoris Causa’ nga Universiteti European i Tiranës. Ky vlerësim lidhet ngushtë me rrugëtimin tonë të përbashkët për sigurimin e të drejtave të shqiptarëve, ndërtimin e paqes

dhe përparimin drejt integritetit euroatlantik të Maqedonisë së Veriut. Ky çmim nuk është vetëm për mua, por për të gjithë ju, për çdo sakrificë, çdo përpjekje dhe çdo hap që kemi bërë së bashku në këtë

rrugë të gjatë. Jam mirënjohës për këtë nderim dhe i vendosur që të vazhdojmë punën për çështjen kombëtare dhe për të ardhmen evropiane të vendit tonë”, ka shkruar Ahmeti në “Facebook”.



Kryeprokurori Isufaj priti në takim drejtuesin e SPAK-ut, diskutuan për thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 1 TETOR - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Kosovës, Blerim Isufaj, ka pritur të mërkurën në një takim pune drejtuesin e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Altin Dumani.

Gjatë takimit u diskutua për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e sundimit të ligjit, shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e koordinimit në hetimet e përbashkëta. Dumani ritheksoi përkushtimin e SPAK-ut për ta mbështetur

Prokurorinë Speciale në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Ndërsa Isufaj shprehu mirënjohjen për bashkëpunimin e vazhdueshëm, duke theksuar se Prokuroria Speciale mbetet shtyllë e fortë dhe e palëkundur e sistemit të drejtësisë në vend.



RAPORTI I IKD-së: TETË KANDIDATË PËR KRYETARË KOMUNASH KANË PROBLEME ME LIGJIN

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 TETOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin lidhur me kandidatët për kryetarë të komunave në zgjedhjet lokale 2025 të cilët kanë aktakuza aktive, apo që janë dënuar më herët me vendime të formës së prerë për vepra të ndryshme penale. Sikurse edhe në ciklet e tjera zgjedhore, edhe në këtë rast IKD-ja, bazuar në të dhënat e saj të mbledhura nga procesi i monitorimit të gjykatave, në këtë raport ka paraqitur kandidatët për kryetarë të komunave të cilët kanë probleme me ligjin. IKD-ja ka avokuar vazhdimisht për dekriminalizimin e politikës, në kuptim që personat të cilët kanë probleme me ligjin, edhe nëse nuk kanë ndalesa specifike ligjore, mos të jenë pjesë e listave zgjedhore dhe bartës të funksioneve të caktuara publike.

Problemet me ligjin konsistojnë qoftë në aktakuza aktive apo dënime të formës së prerë. “Siç është theksuar vazhdimisht, kërkesa për moskandidim të personave të cilët kanë probleme me ligjin nuk nënkupton cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë por se synon të dërgojë një mesazh pozitiv, në atë mënyrë që përdërisa problemet me ligjin nuk përfundojnë, partitë politike nuk kandidojnë persona të tillë. Bazuar në të dhënat e monitorimit të IKD-së, nga 206 kandidatët për kryetarë të komunave, tetë (8) prej tyre apo 3.9% janë persona të cilët kanë probleme me ligjin. Prej tyre, janë gjithsej katër (4) kandidatë të cilët kanë aktakuza aktive, mbi bazën e të cilave aktakuza edhe janë dënuar nga gjykata e shkallës së parë, por se këto dënime ose janë kthyer në rigjykim ose nuk kanë marrë formën e prerë. Ndërkaq, janë identifikuar edhe pesë (5) kandidatë që në të kaluarën janë



dënuar me vendim të formës së prerë”, është thënë në këtë raport të IKD-së. Te kandidatët për kryetarë të komunave që IKD-ja ka gjetur se kanë probleme me ligjin, përfshihen katër (4) kandidatë nga dy parti politike, tre (3) prej tyre nga PDK dhe një (1) nga LV. Përdërisa tre (3) kandidatë janë nga tri iniciativa qytetare, Bashkimi Demokratik i Prizrenit, Srpska Narodna Sloga dhe

Iniciativa Demokracia, kurse një (1) është kandidat i pavarur. Sa i përket shtrirjes sipas komunave të kandidatëve që kanë probleme me ligjin, IKD-ja gjen se kandidatë të tillë evidentohen në gjithsej shtatë (7) komuna. Kandidatët për kryetarë të komunave në zgjedhjet e 12 tetorit 2025 të cilët kanë probleme me ligjin janë akuzuar në 12 raste, për gjithsej 10 vepra të ndryshme penale.

Krahasimisht me zgjedhjet lokale të vitit 2021, IKD-ja gjen se ka përparim sa i përket numrit të përgjithshëm të kandidatëve me probleme me ligjin, numrit të kandidatëve me aktakuza aktive dhe numrit të komunave në të cilat garojnë kandidatë të cilët kanë probleme me ligjin. “Progres, po ashtu, vërehet edhe në numrin e partive politike që përfshijnë në listat e tyre kandidatë për kryetarë të komunave. Në vitin 2021 ishin evidentuar katër (4) parti politike, përdërisa në zgjedhje lokale 2025, janë evidentuar dy (2) parti politike. Mirëpo, në këto zgjedhje janë evidentuar edhe tri (3) nisma qytetare që kanë paraqitur kandidatë të cilët kanë probleme me ligjin, përdërisa një kandidat tjetër është i pavarur, të cilët formalisht trajtohen si subjekte politike. Në anën tjetër, IKD-ja evidenton regres sa i përket numrit të kandidatëve me dënime të formës së prerë”, theksohet në raportin e IKD-së.

SHTOHEN EDHE GJASHTË AUTOAMBULANCA TË REJA PËR KUJDESIN PARËSOR SHËNDETËSOR



PRISHTINË, 1 TETOR - Ministria e Shëndetësisë vazhdon përfundimin e kapaciteteve në Kujdesin Parësor Shëndetësor përmes shpërndarjes së autoambulancave për komunat e Republikës së Kosovës. Pas dorëzimit të gjashtë autoambulancave të reja gjatë muajit qershor, të mërkurën Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar marrëveshje me gjashtë komuna të tjera për shpërndarjen e autoambulancave të tipit Basic Life Support, me vlerë të përgjithshme prej 448 740

eurosh. Në ceremoninë e nënshkrimit morën pjesë zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, si dhe u. d. sekretari i përgjithshëm, Jahë Gecaj, të cilët theksuan rëndësinë e kësaj mbështetjeje për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në nivel lokal. Ministria e Shëndetësisë, përmes këtij investimi, synon ta përmirësojë qasjen e qytetarëve në shërbimet bazë shëndetësore dhe të sigurojë transport të sigurt dhe të standardizuar për pacientët në

nevojë. Po gjatë tremujorit të fundit të këtij viti, Ministria e Shëndetësisë do të shpërndajë edhe tetë autoambulanca të tjera, duke garantuar mbështetje të qëndrueshme për komunat dhe avancimin e mëtejshëm të shërbimeve të Kujdesit Parësor Shëndetësor në vend. Në këtë ngjarje morën pjesë edhe kryetarë dhe nënkryetarë komunash, të cilët pranuan autoambulancat e destinuara për komunat që ata përfaqësojnë.

Maqedonci takon udhëheqësit ushtarakë amerikanë në Forumin e Sigurisë në Varshavë

PRISHTINË, 1 TETOR - Në kuadër të pjesëmarrjes në Forumin e Sigurisë së Varshavës, ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, zhvilloi takime të rëndësishme me përfaqësues të lartë ushtarakë amerikanë dhe ndërkombëtarë. Me këtë rast, ministri Maqedonci u takua me

komandantin suprem të Forcave Aleate për Evropën (2019-2022), gjeneral Tod Daniel Wolters, si dhe me drejtorin e lartë dhe bashkëpunëtorin e lartë në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive (ShBA), Admiral Mark Montgomery.

Gjatë këtyre takimeve u paraqit përparimi i arritur në zbatimin e Planit të Tranzicionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe u diskutua për thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ministri Maqedonci shprehu mirënjohje të veçantë për dy udhëheqësit ushtarakë, të cilët janë miq të dëshmuar të Kosovës dhe kanë dhënë kontribut të çmuar për të zhvilluar dhe për t'i forcuar kapacitetet mbrojtëse të vendit tonë.



SI NDIKON ZBATIMI I RREPTË I LIGJIT PËR TË HUAJT TE SERBËT NË KOSOVË?

PRISHTINË, 1 TETOR - Me parullën “Ne nuk jemi të huaj këtu”, një grup qytetarësh në Zubin Potok, në veri të Kosovës, bllokuan të martën qarkullimin e automjeteve për 15 minuta. Ata protestuan kundër masave të paralajmëruara nga autoritetet e Kosovës, sipas të cilave, automjetet me targa të huaja nuk do të mund të përdoren më me autorizim.

Protesta u thirr nga Lëvizja Popullore Serbe e Millija Bishevacit, i cili është edhe kandidat për kryetar të komunës së Zubin Potokut, ndërsa u mbështet edhe nga Partia Demokracia Serbe e Aleksandar Arsenijeviqit.

Kjo masë, e paralajmëruar nga Policia e Kosovës, hyn në fuqi më 1 nëntor në bazë të Ligjit për Trafikun. Ajo do t'i prekë edhe pjesëtarët e komunitetit serb që kanë vendbanim në Kosovë sipas sistemit serb, por që ngasin makina me targa të qyteteve të Serbisë, duke përdorur autorizim.

Në këtë autorizim gjenden të dhënat e kartës së identitetit të shoferit, të cilën e lëshojnë organet e Serbisë për qytetet në Kosovë, por që Prishtina zyrtare nuk i njeh.

Raste të tilla ka nëpër mjediset me shumicë serbe si në veri, po ashtu edhe në jug të lumit Ibër. Një prej tyre është edhe Millena nga Graçanica, afër Prishtinës, e cila ka një veturë me targa BG (Beograd). Ajo thotë për Radion Evropa e Lirë se nuk mund të blejë makinë në Serbi me emrin e saj, sepse kurrë nuk e ka ndryshuar vendbanimin, ndërsa nuk dëshiron të marrë targa RKS të Kosovës, sepse nuk ndihet e sigurt për të udhëtuar me to në Serbi. “Nuk është e këndshme [të udhëtosh në Serbi me targa RKS], ashtu siç nuk është e këndshme këtu [në Kosovë] të udhëtosh me targa serbe. Shpresoj të gjendet një zgjidhje, sepse ky është një problem i madh për të gjithë ne”, thotë Millena.

Ajo shton se në territorin e komunës së Graçanicës nuk ka transport publik dhe për shumë persona do të kufizohet liria e lëvizjes nëse nuk do të mund t'i përdornin automjetet e tyre me autorizim.

Nga Policia e Kosovës thonë për Radion Evropa e Lirë se përdorimi i targave të huaja me autorizim është në kundërshtim me Ligjin për Trafikun dhe se deri më tani kjo praktikë është toleruar për t'u dhënë kohë qytetarëve t'i ndërrojnë automjetet. Në fund të vitit 2022 Kosova ndaloi përdorimin e makinave me targa të lëshuara nga Serbia, të cilat kryesisht qarkullonin në veri të vendit. Ky vendim shkaktoi tërheqjen e serbëve nga institucionet e Kosovës dhe rriti tensionet në terren.



Masa të reja edhe për qytetarët serbë që nuk kanë dokumente të Kosovës

Përveç masave që kanë të bëjnë me drejtimin e automjeteve me targa të huaja, Policia e Kosovës informon publikun se edhe Ligji për të Huajt do të respektohet me rigorozitet kur bëhet fjalë për dokumentet personale, d.m.th. të gjithë ata që nuk kanë dokumente të Kosovës, do të duhet të aplikojnë për leje qëndrimi.

Policia e Kosovës për Rajonin e Veriut thotë për Radion Evropa e Lirë se nuk dihet ende se kur saktësisht do të fillojë të zbatohet kjo masë, por se, aktualisht, është duke u zhvilluar një fushatë informuese, në kuadër të së cilës është publikuar “Udhëzuesi për hyrjen, lëvizjen, qëndrimin dhe punësimin e të huajve në Republikën e Kosovës”.

Ky manual shpjegon procedurën për marrjen e lejes për “qëndrim afatshkurtër, të përkohshëm ose të përhershëm”.

Tash për tash nuk ka të dhëna të sakta zyrtare se sa serbë jetojnë në Kosovë dhe posedojnë dokumente të Kosovës, sepse pjesëtarët e këtij komuniteti - kryesisht në katër komunat në veri - e kanë bojkotuar regjistrimin e vitit 2024.

Por, bazuar në vlerësimet e shoqërisë civile serbe dhe të autoriteteve lokale në komunat me shumicë serbe, janë rreth 100 000 serbë që jetojnë në Kosovë.

Një raport i vitit 2024 nga organizata joqeveritare “Aktiv”, me titull “Analiza e trendëve, qëndrimet e komunitetit serb”, ka treguar se mbi 93 për qind e 503 të anketuarve kanë dokumente të Kosovës. Prej tyre, pothuajse 90 për qind e të anketuarve në veri të Kosovës kanë dokumente të Kosovës, ndërsa kjo shifër në jug arrin në mbi 97 për qind.

Autoritetet e Kosovës nga

nëntori i vitit të kaluar deri në prill të këtij viti u kanë mundësuar serbëve në Kosovë ta merrnin shtetësinë “me vonesë”, duke marrë parasysh se disa prej tyre nuk mund t'i nxirrnin dokumentet e Kosovës, sepse kishin vetëm certifikata të lindjes të lëshuara nga institucionet serbe, të cilat autoritetet e Kosovës nuk i pranojnë.

Reagimet e shoqërisë civile

Disa organizata joqeveritare serbe pretendojnë se ende ka mijëra serbë të Kosovës që nuk mund të marrin dokumente të Kosovës sepse, siç thonë, “regjistrimi civil i serbëve të Kosovës, si dhe i pjesëtarëve të tjerë të komuniteteve joshumicë, është penguar për shumë vite”.

Organizatat joqeveritare: Qendra për Aksione Sociale Afirmative, Iniciativa e Re Sociale, Instituti për Zhvillim Territorial Ekonomik dhe Aktiv e shohin respektimin kaq strikt të Ligjit për të Huajt, ku përfshihen edhe qytetarët e Serbisë, si qëllim të autoriteteve të Kosovës “për ta vështirësuar dhe penguar” funksionimin e përditshëm të komunitetit serb në Kosovë. “Kjo shmang zgjidhjen e shkakut kryesor përse mijëra serbë, edhe pas më shumë se një dekade integrim, nuk kanë dokumente të Kosovës”, thanë këto organizata në një deklaratë drejtuar komunitetit ndërkombëtar. Sipas tyre, shumë familje kanë së paku një anëtar - në të shumtën e rasteve fëmijë - i cili nuk ka dokumente të Kosovës. Por, Veton Elshani nga Policia e Kosovës thotë për Radion Evropa e Lirë se do të ketë mirëkuptim për rastet e tilla dhe se askush nuk ka ndër mend “ta ndajë nënën nga fëmijët” ose diçka të ngjashme.

Kush tjetër është “në rrezik”?

Disa studentë nga Mitrovica e

Veriut paralajmëruan se masat e marra nga autoritetet e Kosovës në lidhje me regjistrimin e vendbanimit për të huajt mund të ndikojnë në punën e universitetit që vepron brenda sistemit serb.

Profesoresha në Fakultetin e Filozofisë, Senka Kostiq, thotë për Radion Evropa e Lirë se Universiteti i Mitrovicës së Veriut ka një numër të madh studentësh që vijnë nga Serbia dhe nuk kanë dokumente të Kosovës.

E njëjta gjë vlen edhe për profesorët që japin mësim.

Kostiq shton se ajo vetë është nga Çaçaku i Serbisë dhe se nuk është e sigurt nëse do të jetë në gjendje të vazhdojë të hyjë dhe të banojë në Kosovë, duke pasur parasysh se Prishtina zyrtare nuk i njeh institucionet që veprojnë brenda sistemit serb. “Ne nuk kemi asnjë dokument të shkruar nga rektorati ynë që të sillemi në përputhje me broshurën [Udhëzuesin për të huajt] që shfaqet në medie”, thotë Kostiq.

Ajo shpreh dyshimin se njoftimi për respektimin e rreptë të Ligjit për të Huajt lidhet me zgjedhjet lokale, ose më saktë me fushatën për zgjedhjet lokale më 12 tetor në Kosovë, dhe se nuk do të zbatohet në praktikë. Por, nëse autoritetet e Kosovës i zbatojnë masat e shpallura, Kostiq beson se do të gjendet një model që universiteti të funksionojë sipas sistemit serb. “Nuk jam e sigurt nëse do të jetë një variant i mësimi online, siç e kemi përdorur gjatë pandemisë së koronavirusit. Kjo do të varet nga rektorati dhe vetë fakultetet. Mund të jetë një zgjidhje e përkohshme derisa të zgjidhet statusi i komunitetit serb”, thotë Kostiq. “Pres që fakulteti të gjejë një mënyrë për t'u përshtatur, por edhe që Beogradi të ketë një reagim të duhur për atë që po ndodh”, shton ajo.

Thirrjet e partive politike

Lëvizja Popullore Serbe u dërgoi një letër të hapur

ambasadave dhe misioneve ndërkombëtare në Kosovë, duke shprehur shqetësimin e saj për njoftimin se Ligji për të Huajt “do të respektohet në mënyrë strikte”. Kjo parti politike, e udhëhequr nga Millija Bishevac dhe Branimir Stojanoviq, tha se kjo nuk është vetëm një çështje teknike, por se kërcënon seriozisht të drejtat e komunitetit serb në Kosovë, duke përfshirë lirinë e lëvizjes dhe të drejtën për shtëpi dhe jetë familjare.

Lëvizja Popullore Serbe tha se një numër i madh i serbëve në Kosovë nuk janë në gjendje të marrin dokumente të Kosovës dhe se masat e reja do ta rëndojnë edhe më tej jetën e tyre të përditshme. Ajo i kërkoi Qeverisë së Kosovës ta shtyjë urgjentisht “zbatimin e masave të kontestuara derisa të gjendet një zgjidhje e drejtë dhe e qëndrueshme që merr parasysh interesat e të gjithë qytetarëve”.

Kjo parti, gjithashtu, i bëri thirrje bashkësisë ndërkombëtare që të nisë një dialog me serbët vendas për të gjetur një zgjidhje, për të siguruar të drejtën e plotë të lirisë së lëvizjes, qasjen në dokumente, të drejtën për shtëpi dhe jetë familjare, dhe për të mundësuar njohjen e dokumenteve të vlefshme serbe, si dhe qasjen më të lehtë në dokumentet e Kosovës për të gjithë pjesëtarët e komunitetit serb.

Demokracia Serbe e Aleksandar Arsenijeviqit reagoi, po ashtu, duke kërkuar që Qeveria e Kosovës ta shtyjë zbatimin e vendimeve për respektimin e rreptë të Ligjit për të Huajt dhe të gjendet një zgjidhje brenda kornizës së dialogut për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi.

Reagimet nga Beogradi

Më 18 shtator Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë i përshkroi masat e reja nga autoritetet e Kosovës si “kërcënime të reja nga Prishtina” që, siç tha, kanë për qëllim “një valë të re persekutimi dhe dëbimi të serbëve”. “Për shkak të shpalljes së këtyre lëvizjeve të reja përshkallëzuese, Beogradi do t'i kërkojë bashkësisë ndërkombëtare ta ndalojë këtë tërbim të [kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin] Kurti, i cili bart pasoja të paparashikueshme”, tha kjo zyrë.

Në deklaratën e saj u tha, po ashtu, se nëse BE-ja dhe vendet e QUINT-it nuk reagojnë, Beogradi “do të detyrohet të shqyrtojë një përgjigje të përshtatshme politike dhe ligjore ndaj një kërcënimi kaq drastik të të drejtave themelore të popullit serb”.

Shahini: Kosova kryeson në botë me tkurrjen e popullsisë, ekonomia në alarm

PRISHTINË, 1 TETOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka thënë se Kosova po përjeton një rënie historike të popullsisë, më e shpejta në botë. Sipas Bankës Botërore, në vitin 2024 vendi humbi 9.7 % të popullsisë, duke shënuar tkurrje që nuk ka precedent. Nga 1.74 milion banorë në vitin 2011, Kosova ka rënë në vetëm 1.6 milion banorë. Ky fenomen alarmant ndikon drejtpërdrejt në çdo aspekt të jetës ekonomike. “Çfarë do të ndodhë nëse ky trend vazhdon? Konsumi bie

ndjeshëm - më pak të rinj do të thotë më pak kërkesë për produkte dhe shërbime. Tregu i punës ngadalësohet - një popullsi më e vogël dobëson fuqinë punëtore dhe pengon krijimin e vendeve të reja të punës. Rritja ekonomike rrezikohet. Banka Botërore parashikon rritje prej 3.8 % për vitet 2025-2026, por kjo mund të mos mjaftojë për t'i kompensuar humbjet demografike”, ka thënë Shahini. Aleanca Kosovare e Bizneseve kërkon masa urgjente dhe

konkrete. “Mbështetje financiare për familjet - stimuj për rritjen e natalitetit dhe për prindërit. Politika për punësim të prindërve - sidomos për nënat, për të mos humbur talentin dhe eksperiencën. Investime në arsim dhe shëndetësi - për të krijuar kushte më të mira jetese dhe për të mbajtur të rinjtë në vend. Popullsia është themeli i ekonomisë dhe e ardhmja jonë. Kosova nuk mund të presë më - veprimi duhet të jetë urgjent dhe i menjëhershëm”, ka thënë Shahini, kryetar i AKB-së.



NGA BUKA DERI TE PERIMET, QYTETARËT PO PËRBALLLEN VAZHDIMISHT ME NGRITJE TË ÇMIMEVE

Prishtinë, 1 tetor - Në realitetin e përditshëm qytetarët po përballen me një barrë ekonomike gjithnjë e më të rëndë. Çmimet e produkteve ushqimore janë rritur ndjeshëm, duke e bërë gjithnjë e më të vështirë për familjet shqiptare të mbulojnë nevojat bazë të përditshme. Nga buka dhe qumështi, te frutat dhe perimet, çdo artikull në shportën e përditshme ka shënuar rritje. Kjo situatë po thellon pasigurinë ekonomike dhe po prek veçanërisht shtresat e mesme dhe të ulëta të shoqërisë. Të martën edhe Agjencia e Statistikave njoftoi se në gusht çmimet ishin për 4.5 për qind më të larta krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Njohësi i çështjeve ekonomike, Safet Gërxhaliu, ka thënë për “Telegraf”-in se inflacioni po e bën çdo ditë e më shumë të vështirë jetën në Kosovë. “Është vërtet që agjenda politike në Kosovë është duke e ngulatur sektorin privat dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Vetë fakti që kemi masa ndëshkuese nga Bashkimi Evropian dhe nuk ka projekte të cilat mund të jenë infuzion për mbështetje për zhvillim ekonomik, për mbështetje të sektorit privat është një situatë e vërtetë shqetësuese”, theksoi ai. Gërxhaliu, po ashtu, theksoi se



edhe mungesa e institucioneve e ka bërë që të rëndohet edhe më shumë situata ekonomike. “Dhe lind pyetja, po të mos ishte edhe ndihma nga diaspora, atëherë çfarë kishte me ndodhë me Kosovën, paramendoni të kemi vetëm pesëdhjetë për qind rënie të remitancave, çfarë situatë sociale kish me qenë në Kosovë? Vërtet e trishtë. Mirëpo, ajo çka është duke rënduar situatën

aktuale në Kosovë është një inflacion, i cili vërtet po e bën dhe po e vështirëson edhe të jetuarit në Kosovë”, nënvizoi ai. Duke folur për çmimet e larta, Gërxhaliu tha se në Kosovë ka rënë në mënyrë drastike fuqia blerëse. “Fakti që në mënyrë zyrtare kemi një në inflacion 4 apo 5 për qind, ndoshta është më tepër në realitet, atë çfarë e keni blerë para sa vitesh, me njëqind

euro sot nuk mjaftojnë 200 euro”, theksoi ai. Derisa çmimet vazhdojnë të ngrihen çdo ditë, Gërxhaliu tha se pagat kanë mbetur të ngrira. “Dhe në këtë drejtim kemi paga të ngritura qoftë në sektorin privat, qoftë në administratë dhe kur dihet fakti tjerë, që Kosova është shndërruar në një vend të varur nga importi, kemi rritje enorme të importit, situata

aktuale është mjaft shqetësuese”, ka thënë mes tjerash ai. Ai ka pohuar se e më e keqja është se kjo është si një metastazë që godet më së shumti shtresën e mesme dhe të varfër. “Duke pasur parasysh faktin që në Kosovë kemi shumë tepër shtresë të nivelit të ulët sesa të lartë, atëherë situata vërtet është mjaft shqetësuese dhe vetë fakti që tani kemi një situatë pa institucione, kemi ngritje të çmimit të energjisë elektrike”, deklaroi ai. Sipas Gërxhaliut, një shtet i varur nga importi ka pak mundësi për të gjetur zgjidhje për ta ulur inflacionin. “Ky është realiteti që vërtet në Kosovë fuqia blerëse është çdo ditë e më ulët dhe situata është shumë pak shpresëdhënëse, dhe kur e kemi parasysh që politika është shumë tepër e orientuar për pushtet, sesa për qytetarë dhe për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm”, u shpreh ai. Agjencia e Statistikës e Kosovës (ASK) ka paraqitur të martën për përdoruesit Vjetarin Statistikor të Republikës së Kosovës për vitin 2025. Në raport vërehet se produktet ushqimore bazë kanë përjetuar ngritje nga viti në vit, ndërsa është bërë publike edhe niveli i pagës mesatare bruto dhe neto që nga viti 2012 deri në vitin 2024.

ASK-ja paraqet Vjetarin Statistikor

PRISHTINË, 1 TETOR - Agjencia e Statistikës e Kosovës (ASK) ka paraqitur për përdoruesit Vjetarin Statistikor të Republikës së Kosovës për vitin 2025. Vjetari Statistikor është publikuar për herë të parë në vitin 2014 dhe përfaqëson një nga botimet më të veçanta, më të rëndësishme dhe më gjithëpërfshirëse të ASK-së. Qëllimi kryesor i këtij vjetari është të ofrojë një përmbledhje

të plotë të statistikave sociale, ekonomike dhe bujqësore për një periudhë të caktuar, në një botim të vetëm. Ai paraqet, në mënyrë të hollësishme dhe në bazë vjetore, një gamë të gjerë statistikash nga sektorët përgjegjës të ASK-së, duke përfshirë shumë të dhëna të rëndësishme statistikore në seri të ndryshme kohore për Republikën e Kosovës. Vjetari Statistikor është i ndarë në 23 kapituj, të cilët përmbajnë

tabela, grafikë dhe harta, me qëllim që të ofrojnë të dhëna të plota të strukturave sociale, ekonomike dhe bujqësore në vend. Në përmbajtjen e tij, Vjetari ka sistemuar dhe koordinuar në mënyrë të qëndrueshme përbërësit më thelbësorë të informacionit statistikor, që shërben për të ilustruar një pamje të gjerë të proceseve shoqërore, ekonomike dhe bujqësore në Republikën e Kosovës.



PALESTINA IMAGJINARE

Evropianët po njohin një shtet që nuk ekziston dhe që, po të varej prej tyre, s'do të ekzistonte kurrë



«Ishte prekje ta shihje Sir Starmer-in të shpallte javën e kaluar, nga një korridor i Downing Street, vendimin e qeverisë së tij për të njohur shtetin e Palestinës», shkruan Douglas Murray në The Spectator. «Starmer ndërmori këtë veprim “të guximshëm” njëkohësisht me homologët e tij francez, kanadez dhe australian. Por, si në rastin e Emmanuel Macron-it, Mark Carney-t dhe njëfarë Anthony Albanese, dukej se ishte viktimit e një sërë keqkuptimesh. I pari ishte ideja se kjo do të bënte ndonjë ndryshim. Starmer dhe homologët e tij jashtë vendit duken se besojnë gabimisht se krijimi i shteteve është ende në duart e tyre. Mendoja se gjenerata aktuale e së majtës përçmonte fuqitë imperialiste perëndimore që kryenin ndërhyrjet e tyre koloniale në rajone të huaja. Por me sa duket s'është kështu, nëse “shteti” në fjalë quhet Palestinë.

Arsyeja e dytë pse njoftimi ishte kaq pak i rëndësishëm është se nuk ekziston asnjë nga parakushtet për shtetin palestinez.

Nuk ka një leadership palestinez koherent. As që ekziston një territor palestinez i pandërprerë. Tani ngulin këmbë në mënyrë të paqartë për zgjedhje, por herën e

fundit që palestinezët votuan, votuan për Hamasin.

Nuk ka marrëveshje se cilat do të jenë marrëdhëniet mes “Palestinës” dhe fqinjit të saj më të afërt. Dhe as për kryeqytetin e kësaj Palestine nuk ka dakordësi. Kush do ta mbikëqyrë arsimin në këtë shtet të ri? A do të jetë një tjetër organizatë “mrekullibërëse” e Kombeve të Bashkuara, që do t'u lejojë xhihadistëve të indoktrinojnë një brez tjetër palestinezësh me idenë se qëllimi i tyre më i lartë në jetë është çrrënjësia e hebrenjve? A do të ketë një aeroport apo një ushtri? Ndoshta Starmer, David Lammy dhe Yvette Cooper kanë një plan të qartë — ose një “rrugë” — për t'iu përgjigjur të gjitha këtyre pyetjeve, duke shpjeguar edhe propozimet e tyre të sakta për shkëmbime popullsie për zonat A, B dhe C të Judesë dhe Samarisë. Dhe supozoj se, pasi qeveria jonë të ketë përcaktuar kujt i përket territori dhe t'i ketë njoftuar popullsinë vendase se është gati të dërgojë trupa britanike për ta zgjidhur çështjen, do të ketë një mirëseardhje të madhe pozitive në rajon, nga të gjitha palët, për mbërritjen e këtyre “mbrojtësve” britanikë.

Atëherë, cila është saktësisht logjika e të njohurit diçka që nuk ekziston dhe për të cilën s'do të gjendet marrëveshje? Hamas iu përgjigj njoftimeve duke falënderuar Starmer-in dhe homologët e tij. Sipas tyre, njohja

e shtetit është një shpërblim për masakrat e kryera më 7 tetor 2023 dhe për dy vitet e luftës që pasuan. Është një mësim i jashtëzakonshëm t'u mësohet terroristëve në Gaza, si edhe gjetkë, që gjithçka që duhet të bësh, nëse do një shtet që e ke refuzuar vazhdimisht, është të vërshosh nëpër fshatra dhe të hapësh rrugën duke vlarë e dhunuar, duke marrë pengje përgjatë udhës. Më habit disi që, duke parë “suksesin” e veprimeve të Hamasit, njerëz me arsye shumë më të forta për të kërkuar një shtet — si kurdët për shembull — nuk vendosin të shkojnë të dhunojnë e djegin edhe ata nëpër fshatrat fqinj.

Ç'kuptim ka të njohësh diçka që nuk ekziston dhe për të cilën s'do të gjendet marrëveshje?

Ndërkohë, u desh sekretari amerikan i shtetit Marco Rubio për të vënë në dukje diçka që asnjë prej politikanëve tanë nuk do ta thoshte: arsyeja kryesore pse këto qeveri janë sjellë në këtë mënyrë s'ka të bëjë fare me punët ndërkombëtare. Qeveritë e mëparshme janë përpjekur për më shumë se një shekull t'i bindin palestinezët të pranojnë një shtet që bashkëjeton me fqinjin e tyre hebre. Çdo iteracion i leadershipit palestinez që atëherë e deri tani ka qenë i një mendjeje: një shtet Palestinë duhet të përfshijë të gjitha vendet fqinje — përfshirë

Izraelin — dhe ky shtet palestinez duhet të jetë krejtësisht pa hebrej.

Pra, jo, asgjë nga këto s'ka të bëjë me një kthesë negociuese.

Ka të bëjë — siç tha Rubio — me presionin politik të brendshëm në çdo vend perëndimor.

Përveçse vuri në dukje se këto “njohje” kanë kontribuar në dështimin e negociatave me Hamasin për dorëzimin e 48 pengjeve të mbetura, Rubio theksoi se Britania e Madhe dhe shokët e saj e kanë njohur shtetin e Palestinës vetëm sepse politikën e imigracionit të vendit tonë na kanë përmbytur me të huaj që janë bërë politikisht aktivë dhe këmbëngulin që qeveria e tyre të bëjë gjëra të tilla. Është një gjuhë që asnjë politikan britanik s'do të preferonte ta përdorte. Po ta bënin, do të sillte debate të dhimbshme në divanet e BBC-së.

Megjithatë, Rubio ka të drejtë.

Gjatë dy viteve të fundit kam kaluar kohë në secilin prej vendeve që sapo kanë njohur shtetin palestinez dhe në secilin prej tyre mund të vërehet i njëjti skemë. Nga Kanadaja në Australi, nga Mbretëria e Bashkuar në Francë, secili prej këtyre katër vendeve ka parë protesta të përsëritura nga emigrantë

myslimanë që kërkojnë një “Palestinë të lirë”. Sigurisht, nuk bëhet fjalë vetëm për emigrantë. Janë edhe disa shpirtë të humbur që kanë vendosur se qëllimi i jetës së tyre mund të gjendet më së miri duke u lyer flokët blu, duke vënë një shami në stilin e “terroristit palestinez” dhe duke këmbëngulur se askush s'do të jetë i lirë derisa “Palestina” të jetë e lirë. Nëse mendoni se frikësimi prej këtyre turmave nuk ka efekt, mendoni se si një protestë pro-palestineze ndryshoi rrjedhën e procedurave parlamentare në Westminster në fillim të vitit të kaluar. Siç deklaroi në atë kohë ish-kryeministri Rishi Sunak, po formohet një “konsensus në rritje se fuqia e turmës po zëvendëson fuqinë demokratike” — një vëzhgim që u injorua sapo u bë. Ose shikoni Italinë, ku qeveria e Giorgia Meloni-t nuk iu bashkua garës për krijimin e një shteti. Në përgjigje, një turmë marshoi në qendër të Milanos me kefije të detyrueshme dhe një grup tentoi të sulmonte Stacionin Qendror duke u përplasur me forcat e rendit.

Mund të vijë një ditë kur një shtet palestinez mund të ekzistojë. Por kushtet për ekzistencën e atij shteti aktualisht nuk ekzistojnë. Starmer dhe të tjerët s'kanë bërë asgjë për të kontribuar në paqen në Lindjen e Mesme. Por supozoj se ia dolën ta shtynë edhe një ditë përballjen me problemet tona dhe të ruajnë një farë shkalle “paqeje” brenda vendit, për momentin». / bota.al

EUROPA KËRKON TË RRËZOJË AVIONËT RUS SI DIKUR TURQIA (POR ANKARAJA ‘U BRAKTIS’ NGA NATO)

Një valë shkeljesh të hapësirës ajrore të NATO-s nga Rusia muajin e kaluar i ka shtyrë disa aleatë të kujtojnë reagimin e shpejtë dhe vdekjeprurës të Turqisë një dekadë më parë, kur ajo rrëzoi një avion luftarak rus që kishte kaluar kufirin e saj jugor. Ministrja lituaneze e Mbrojtjes, Dovile Sakaliene, tha në një postim në X, se Turqia "dha një shembull 10 vjet më parë" për NATO-n, ndërsa kërkoi veprime më të forta përballë "testeve" të Rusisë sot. Megjithatë, në vitin 2015, Turqia u ndje e ekspozuar nga ajo që e shihte si reagim të vakët të NATO-s dhe nga pasojat ekonomike nga rrëzimi i avionit rus. Kjo e shtyu Ankaranë përfundimisht - dhe ironikisht - të kërkonte lidhje më të ngushta me Moskën, të cilat kanë vazhduar edhe mes luftës së Rusisë në Ukrainë. Më 24 nëntor 2015, një avion turk F-16 rrëzoi një Su-24 rus pranë kufirit sirian. Pamjet dramatike treguan aeroplanin në flakë duke u përplasur me shpejtësi në një kreshtë të pyllëzuar, duke shënuar angazhimin e parë të tillë ushtarak midis një anëtari të NATO-s dhe Moskës që nga

krijimi i aleancës në vitin 1949. Turqia, e cila ka ushtrinë e dytë më të madhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, tha se kishte lëshuar paralajmërime të përsëritura përpara se të zgjidhte rregullat e përhershme të angazhimit. Moska mohoi çdo shkelje, ngriu marrëdhëniet dhe vendosi kufizime tregtare dhe turistike ndaj Ankarasë. Brenda pak orësh, NATO mbledhi një takim urgjent dhe shprehu solidaritet mbi integritetin territorial të Turqisë, por gjithashtu bëri presion për qetësi. Hapat e saj të mëtejshëm, duke përfshirë fluturimet e mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të hershëm, ishin të dizajnuara për të ulur tensionet, jo për të nxitur konfrontim. Por zyrtarët thanë se kjo e la Turqinë të ndihej ende e cënueshme përballë Rusisë, fqinjit të saj në Detin e Zi, me të cilën ishte tashmë e angazhuar në një luftë me ndërmjetës në Siri, ku Moska mbështeti Presidentin e atëhershëm Bashar al-Assad dhe Ankaraja mbështeti rebelët. Ekonomia e Turqisë u godit rëndë nga kufizimet tregtare të Rusisë dhe më vonë ajo lëshoi atë që Moska e quajti një kërkimfalje. Në fillim, Turqia iu



drejtua aleatëve të NATO-s për të forcuar mbrojtjen e saj, por vendosi të mos blinte raketa amerikane Patriot për shkak të kostos. Më vonë - e nxitur nga një grusht shteti i dështuar në vitin 2016 dhe një afrim me Moskën - ajo bleu sistemet ruse S-400, duke shkaktuar sanksione nga SHBA-ja dhe heqjen e Turqisë nga një program ndërtimi dhe blerjeje për avionët F-35, pasoja që ende tensionojnë

marrëdhëniet SHBA-Turqi. Presidenti i Turqisë, Tayyip Erdogan, ka krijuar marrëdhënie të përzemërta me homologun e tij rus Vladimir Putin, duke refuzuar t'u bashkohet sanksioneve perëndimore ndaj Moskës dhe duke pritur bisedime midis delegacioneve ruse dhe ukrainase, megjithëse paqja mbetet larg. Lufta në Ukrainë, në vitin e saj të katërt, ka transformuar

peizazhin e sigurisë së Evropës dhe në muajt e fundit ka kërcënuar të përhapet në shtetet anëtare të NATO-s në Evropën Lindore. Polonia rrëzoi dronë më 10 shtator mbi territorin e saj pas asaj që Kryeministri Donald Tusk e quajti një "provokim në shkallë të gjerë" nga Rusia. Estonia tha se tre avionë ushtarakë rusë shkelën hapësirën e saj ajrore për 12 minuta më 19 shtator.

ARRESTIMI I 11 SERBËVE PËR TENTATIVË DESTABILIZIMI NË EUROPË, GJERMANIA: RREZIK NË RRIJTJE PËR SABOTIME

Ministria e Brendshme e Gjermanisë ka paralajmëruar të mërkurën për një rritje të rrezikut për "aktiviteteve sabotuese" në vend. Kështu tha për Shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë një zëdhënës i Ministrisë gjermane, pak ditë pas arrestimit të 11 të dyshuarve në Serbi për shkaktim të incidenteve në Gjermani dhe Francë. Të arrestuarit në Serbi akuzohen për nxitje të grupit për të kryer vepra penale, diskriminim racor dhe diskriminim të ndryshëm, si dhe spiunazh. Ata u arrestuan në Smederevë më 29 shtator dhe dyshohen për hedhjen e ngjyrës së gjelbër në Muzeun e Holokaustit, në disa sinagoga dhe në një restorant hebraik në qendër të Parisit, si dhe për vendosjen e kokave të derrave pranë vendeve fetare myslimane në atë qytet. Gjithashtu, ata shkruan

mesazhe diskriminuese pranë Portës së Brandenburgut në Berlin. "Shërbimet federale të sigurisë po hetojnë gjithashtu raste në të cilat individë dyshohet se janë rekrutuar nga shërbime shtetërore të huaja për të kryer akte të tilla", tha ai për Radion Evropa e Lirë. Zëdhënësi shtoi se këta individë, të njohur edhe si "agjentë me profil të ulët" ose "agjentë të konsumatorit", shpesh rekrutohen përmes rrjeteve sociale dhe shërbimeve të mesazheve. Në përgjigje thuhet gjithashtu se policia dhe shërbimet e inteligjencës kanë nisur një fushatë mediatike që synon paralajmërimin për përpjekjet e rekrutimit nga shërbimet armiqësore të inteligjencës. Pas arrestimeve në Smederevë, policia serbe njoftoi se po kërkonte një të dyshuar i cili, "me udhëzime të një shërbimi të inteligjencës së huaj", organizoi



dhe trajnoi një grup qytetarësh serbë në territorin e Serbisë për të shkaktuar incidente në Gjermani dhe Francë. Zyrtarët francezë po hetojnë rolin e Rusisë në këto incidente,

duke i përshkruar ato si operacione destabilizuese që nxisin tensionet sociale dhe zgjerojnë përçarjet në Francë. Megjithatë, Rusia nuk përmendet në deklaratat e

policisë dhe prokurorisë serbe, dhe autoritetet nuk iu përgjigjën pyetjeve të Radios Evropa e Lirë se cili shërbim i inteligjencës së huaj nisi trajnimin e qytetarëve serbë./REL/



FFK-ja sjell risi në komunikimin me opinionin publik

PRISHTINË, 1 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka sjell një tjetër risi në komunikimin me opinionin publik. Është bërë me dije se çdo të mërkurë në platformat e kësaj federate do të transmetohet “FFK Podcast”, ku do të flitet vetëm për futbollin. “Tashmë po vjen ‘FFK

Podcast’. Ky format i ri do të shërbejë për diskutime rreth futbollit, zhvillimin, vizionin dhe sfidat me të cilat përballlet sporti më i popullarizuar te ne. Mysafir i emisionit të parë në ‘FFK Podcast’ është presidenti Agim Ademi, i cili ndan rrëfime ekskluzive për

udhëtimin e futbollit të Kosovës, planet për të ardhmen dhe angazhimin e tij për zhvillim të vazhdueshëm. ‘FFK Podcast’, aty ku flitet për futbollin! Çdo të mërkurë në orën 20:00 në kanalën e FFK-së në ‘Youtube’ dhe në rrjete sociale”, ka njoftuar FFK-ja.



TETORI KUQEZI, NJË MUAJ PLOT NDESHJE DHE EMOCIONE PËR KOMBËTAREN SHQIPTARE



Tiranë, 1 tetor - Pas një shtatori të mbushur me emocione, tetori do të sjellë sërish një kalendar të ngjeshur me ndeshje për të gjitha kombëtarët shqiptare. Nga Kombëtarja A, te skuadrat e moshave dhe vajzat kuqezi, të gjitha ekipet do të zbresin në fushë për ta përfaqësuar Shqipërinë. Kombëtarja A do të përballlet më 11 tetor në transfertë ndaj Serbisë në Leskovic, një duel i rëndësishëm për eliminatorët e Kupës së Botës 2026, ndërsa më 14 tetor kuqezinjtë do të rikthehen në “Air Albania” për miqësoren

ndaj Jordanisë. Vajzat e Kombëtares A do të kenë një muaj vendimtar, me dy përballje ndaj Qipros që do ta përcaktojnë fatin e tyre për sezonin e ardhshëm në Ligën e Kombeve. Edhe Kombëtarja U-21 do të luajë në “Air Albania”, ku do ta presë San Marinon më 10 tetor, ndërsa ekipet kombëtare U-19 dhe U-17 do të zhvillojnë miqësore përgatitore ndaj Irlandës dhe Sllovenisë. Tetori do të shënojë gjithashtu nisjen e dy turneve të

rëndësishme të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit (FShF) në Shqipëri, fazën kualifikuese të UEFA European Women's Under-17 Championship dhe turneun UEFA Development U-15. Vajzat U-17 do t'i masin forcat me Greqinë, Izraelin dhe Estoninë në Elbasan dhe Rrogozhinë, ndërsa djemtë U-15 do ta sfidojnë Armeninë, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën në “Shtëpinë e Futbollit”. Një muaj i tëri kuqezi për t'u shijuar, me sfida të mëdha dhe përcaktuese.

MBAPPE VENDOS NJË TJETËR REKORD NË LIGËN E KAMPIONËVE

MADRID, 1 TETOR - Me tri golat e shënuara ndaj Kairat Almatyt, Kylian Mbappe i është bashkuar grupit të gjashtë futbollistëve që i kanë shënuar nga 60 gola në Ligën e Kampionëve. Yllit francez i janë nevojitur 89 ndeshje në garën më prestigjioze të futbollit evropian për t'i kaluar Cristiano Ronaldon, Karim Benzeman e Raul Gonzalezin, të cilëve u janë nevojitur më shumë ndeshje për ta arritur këtë shifër golash. Legjenda e Real Madridit, Raul Gonzalez, kishte shënuar 60 gola pas 115 ndeshjesh të zhvilluara. Për Topin e Artë Benzema i ishin dashur 111 ndeshje për ta arritur këtë numër golash, kurse “CR7”



e kishte bërë këtë pas 98 ndeshjesh të zhvilluara. Me tri golat në Kazakistan, Mbappe ka hyrë në mesin e tre lojtarëve që i kanë shënuar më së shpejti 60 gola. Lionel Messi është i pari në këtë listë pasi ka shënuar kaq gola për 80 ndeshje, kurse Robert Lewandowski është i dyti me 85 ndeshje (60 gola). Sa i përket moshës, Mbappe është bërë lojtari i dytë më i ri që e arrin shifrën e 60 golave me 26 vjet e 284 ditë, kurse primatin absolut e mban Lionel Messi me 26 vjet e 86 ditë. “CR7” e kishte arritur këtë numër golash me 29 vjet e 21 ditë, derisa Rauli renditet në vendin e katërt me 30

vjet e 237 ditë. Më tutje renditen Karim Benzema e Robert Lewandowski me nga 31 vjet. Mbappe njëherësh ka hyrë në histori të Real Madridit pasi i është bashkuar Ronaldo Nazarios, Karim Benzemas dhe Cristiano Ronaldos, duke u bërë lojtari i katërt i “Los Blancos” që arrin të shënojë “hat-trick” jashtë “Santiago Bernabeut” në Ligën e Kampionëve. Kampioni i botës me Francën, po ashtu, ka lëvizur në pozitën e gjashtë si golashënuesi më i mirë në Champions, duke e kaluar Thomas Mullerin, i cili është ndalur në 57 gola. Përfaqësuesi francez, në fakt, i ka shënuar 5

gola në këtë edicion të këtij kompeticioni pasi paraprakisht kishte shënuar dy herë ndaj Marseillet në xhiron e parë të fazës së ligës. Natyrisht, ish-futbollisti i Monacos dhe i Paris Saint-Germainit do të mundohet t'i kalojë edhe yjet e tjerë, por do ta ketë të vështirë ta arrijë rekordin e pabesueshëm dhe primatin absolut të Cristiano Ronaldos me 140 gola në Ligën e Kampionëve. Natyrisht, do ta ketë të vështirë ta zë edhe Leo Messin, i cili i kishte shënuar 129 gola në Champions, kurse Lewandowski është i treti me 105 gola. Ndër të tjera, Benzema ka shënuar 90 gola, kurse Raul 71.

Bersant Celina pritët të ftohet nga Foda

PRISHTINË, 1 TETOR - Mesfushori i AIK Fotboll, Bersant Celina, pritët të jetë pjesë e grumbullimit të Kombëtares së Kosovës për ndeshjet e këtij muaji në kuadër të kualifikimeve për Botërorin 2026. Selektori i Kosovës, Franco Foda, këtë javë pritët ta publikojë

listën e lojtarëve të ftuar për ndeshjet me Slloveninë në shtëpi dhe Suedinë në udhëtim. “Dardanët” javën tjetër do ta fillojnë grumbullimin për këto dy përballje që do t'i luajnë më 10 dhe 13 tetor. Celina herën e fundit ka luajtur për Kosovën në

mars të vitit të shkuar, ndërsa në një intervistë për mediumet suedeze ka thënë se ka biseduar në telefon me selektorin Foda. Po ashtu, Celina javë më parë është takuar edhe me presidentin e FFK-së, Agim Ademi, që ishte në vizitë në Suedi

dhe, gjithashtu, takoi edhe Arbër Zenelin. Celina ka 36 paraqitje me Kosovën dhe 1 gol të shënuar, ndërsa këtë sezon ka treguar paraqitje të mira te skuadra e AIK-ut, ku në 30 paraqitje ka realizuar 8 gola dhe ka asistuar 5 herë.



Thirrje për aplikim

Uka Farm - Diellëza Uka B.I. – Perfagesuar nga Dielleza Uka, po kërkon ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë/propozim për:

“Ngritja e serrës për kultivimin e mjedrës në sipërfaqe 0.36ha”

Nr. Prokurimit: FK 01-2025

Emri: Uka Farm - Diellëza Uka B.I.

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes

e-mail: uka.diellza@hotmail.com

Adresa: Ramë Uka, Podujevë

Tel: +383 (0) 44 551 746

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, **ora 14:00**, në Adresa: Ramë Uka, Podujevë.

Thirrje për Aplikim

Kompania: Samire Millaku Jusufi B.I

NUI: 811467639

Adresa: Skender Rexhepi, p.n-Klinë

Kërkon ofërtues/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzoj ofertë për projektin me titull:

Ngritja e serrës së re: me sipërfaqe prej 4000 m², me infrastrukturë përcjellëse

Investimi pëfshinë: *Ndertimin e serrës së re me sipërfaqe prej 4000 m², me profile të zingëruara komplet, duke përfshirë edhe Hapjen e serrës anësore automatike me panel elektronik me 2 sete.*

Investimi do të bëhet në adresën: **Skender Rexhepi, p.n-Klinë**

Kompanit e interesuar mund të kontaktojnë nëpërmjet email: **samiremillaku@gmail.com** apo telefonit **049-883-645** dhe shprehja e interesit të bëhet në adresën e lartë cekur dhe duhet të bëhet me se largu pesë (5) ditë nga data e shpalljes/publikimit. Ndërsa, afati kohor për të dorëzimin e ofertave është të paktën dhjetë (10) ditë, nga data e dergimit të fteses për koutim tek të gjithë ofertuesit/kompanit e interesuara.

Kompanit e interesuar, do të marrin specifikacionin dhe do të ftohen për ofertë financiare.

Kriteret e përzgjedhjes, oferta e përgjegjshme dhe me çmimin me të ulët.

Për çdo sqarim dhe info kontaktoni në numrin:

+383-049-883-645



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- N.P.T. “Fatosi-Com” Adem Krasniqi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues” 810474627 me nrb: 80606524.
- “Kalaja”, Sh.P.K me numër Unik identifikues: 810246159 shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me numër: 330008921.
- Fazli Buduri shpall të pavlefshme diplomën e QK “11 Marsi”, Prizren.
- Leonida Deda nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme të ultë “Lush Marku” Brekoc, Gjakovë.
- Xhenajeva Trans shpall të pavlefshme certifikatën e Export-Import me numër: 330271180.
- Berat Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Luigj Gurakuqi” Nashec.
- Florind Gurazi shpall te pavlefshme 1 dëftesë Q.K “11 Marsi” Prizren.
- “Vr Digital Agency” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811430686.
- “Reisa 2022” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr 330514530.
- “Fire Protection Agency Rifel Action” LLC. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.
- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.
- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.
- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1903

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

